

VENDIM
Nr. 278 ,datë 20.6.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN E ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000, TË
KESHILLIT TË MINISTRAVE “ MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË
KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Ne mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ne Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendim nr date 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave, tC bëhet ky ndryshim:

Neni 292, me titull “Modeli dhe karakteristikat e lejes së drejtimit, (neni 115 i Kodit Rrugor) ndryshon si me poshte vijon:

(neni 115 i Kodit Rrugor)

1. Modeli i lejes së drejtimit të motomjeteve dhe automjeteve rrugore të prodhohet me parametra, që të respektojnë standardet e vendosura nga Komuniteti Europian

2 Për të shmangur mundësinë e falsifikimit, leja e drejtimit të përbëhet nga elemente të larta sigurie (vizive dhe të kontrollueshme, nëpërmjet pajlsjeve të specializuara)

3. Karakteristikat e lejes së drejtimit përcaktohen në modelin përfundimtar të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili bëhet pjesë përbërëse e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor.

4. Mënyra, procedura e lëshimit të lejes së drejtimit, hollësitë e tjera të nevojshme dhe periudha e vlefshmërisë së modelit të vjetër të lejes së drejtimit ose e bashkëvlefshmërisë së tyre me modelin e ri të lejes së drejtimit përcaktohen me udhëzim të ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI
PANDELI MAJKO